REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 8

Rrogozhinë, më 19.08.2025 ora 10 : 00 ᵒᵒ

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës Njoftim, të thirrur nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak, me shkresën Nr.3345.Prot datë 15.08.2025 me rend dite si më poshtë :

1- Miratim i rendit të ditës.
2- Miratim i procesverbalit Nr.7, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 15.07.2025.
3- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%".
4- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2025 nga fondi i pushtetit vendor".
5- Miratim i projekt - vendimit, Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi "Subvencionimi interesave të kredisë për vitin 2025".
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.
- Ditën e Hënë përfundon dhe do i përcillet për shqyrtim KB, një projektvendim shtesë për 4-5 familje të tjera përfituese nga programi "Subvencionimi i interesave të kredisë për vitin 2025".
6- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit 'Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese ' ".
7- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjen vendore Bashkia Rrogozhinë".
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.
8- Miratim i projekt-vendimit, "Mbi shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.14, datë 26.03.2024 'Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë ' ".
9- Informacion mbi situatën e zjarreve dhe masat që do të merren në vijim për parandalimin e tyre në bashkinë tonë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

10- Raportim nga drejtoria e financës mbi realizimin e treguesve ekonomike-financiare për 6-mujorin e I-rë të vitit 2025 në Bashkinë Rrogozhinë.
11- Informacion nga drejtoria e politikave urbane për punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve on - line, projekteve të reja, proçesin e legalizimit dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave.
12- Të ndryshme.
-Kërkesë nga poeti z.Hekuran Dedej.
Shqyrtohet e njëjta kërkesë e vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Sokol Gosa, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Lije Dedej, Mitat Daja, Lorena Baku, Altin Tosku, Erind Tosku.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Astrit Mërtiri - Administrator i NjësisëKryevidh.
4. Deshir Gjumsi - Administrator i Njësisë Lekaj.
5. Denis Sako - Administrator i Njësisë Gosë.
6. Mexhit Saliu - Administrator i Njësië Sinaballaj.
7. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
8. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
9. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
11. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
12. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
13. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

15. Besnik Dushku - Shefi i stacionit të MZSH-së Rrogozhinë.
16. Adriatik Leka - Përgjegjës i Emergjencave Civile.
17. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
18. Ismail Broli - Përgjegjës i Lejeve Zhvillimore.
19. Dorina Shehi - Përgjegjëse e Kadastrës.
20. Marjeta Kuqi - Përgjegjëse e Sektorit të Projektimit dhe Menaxhimit të Kontratave .
21. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
22. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : 11 Këshilltarë, z. Enver Memolla i bashkohet mbledhjes në minutën e 3 të zhvillimit të saj duke e çuar në 12 numrin e këshilltarëve në sallë, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Sokol Gosa, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari. Jemi gjithsej 11- Këshilltarë.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 15.07.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 24 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 25 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Para se të kalojmë në rendin e ditës kemi një projektvendim shtese për miratimin e një marrëveshjeje... të cilën mendoj ta dëgjojmë drejtoreshën juridike të na japë një shpjegim mbi arsyet e këtij propozimi të momenteve të fundit dhe pastaj vendosim nëse do e përfshijmë në rend dite apo jo.
Fjala për drejtoreshën juridike znj . Enkela Ballabani.

Enkela Ballabani . Ky është një projektvendim për trajnimin dhe kualifikimin profesional të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi. e punonjësve të bashkisë dhe të zgjedhurve . Dhe kërkohet miratimi i marrëveshjes për krijimin e persomit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (Talga). Arsyeja që vjen me vonesë është sepse unë relacionin e përfundova dje.

-Mbledhjes i bashkohet Këshilltari z. Enver Memolla në minutën e 3 të zhvillimit të saj.

Mukades Gixhari . Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim?

Hekuran Xhani . Ky është një projektvendim që i shërben administratës dhe këshillit nuk bëhet fjalë për vlera të mëdha financiare , këtu thjeshtë është anëtarësimi i bashkisë Rrogozhinë me këtë ... Indrit këtu nuk ka asgjë unë them ta votojmë. Unë jam dakord të kalojë.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 kundër, 0 abstenim përfshirja në rendin e ditës të projektvendimit me Nr.3379.Prot datë 19.08.2025 "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajtimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (Talga)", si dhe relacionin e këtij projektvendimi me Nr.3379/1.Prot datë 19.08.2025.*

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. Jeni dakord, e hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika e 1 (një) e rendit të ditës.*

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.7, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 15.07.2025. E hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika e 2 (dy) e rendit të ditës.*

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%". Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Kemi 17 familje dhe fondi është rreth 70 mijë lekë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike, materialin e keni të gjithë. E hedhim në votim. Pro kundër abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika e 3 (tre) e rendit të ditës.*

Vendim nr.26. Miratohet me 12 vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3289.Prot datë 12.08.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%", si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3289/1.Prot datë 12.08.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2025 nga fondi i pushtetit vendor". Jemi po me z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Janë 13 familje përfituese dhe fondi është 67 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika 4 (katër) e rendit të ditës.*

Vendim nr.27. Miratohet me 12 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3288.Prot datë 12.08.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2025 nga fondi i pushtetit vendor", si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3288/1.Prot datë 12.08.2025.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, miratim i projekt - vendimit, Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi "Subvencionimi interesave të kredisë për vitin 2025". Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025. Do relatojë po drejtori z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Atëherë janë 8 familje përfituese që plotësojnë të gjitha kriteret,

Mukades Gixhari . Atëherë ndonjë diskutim rreth kësaj pike? Kush e do fjalën?

Ledian Hasani . Të gjithë bashkitë ose si kanë hapur fare ose i kanë hapur një herë unë i kam hapur tre herë.

Indrit Dedej . E kam fjalën që të përfitojnë shtresa më e dobët me i ndihmuar dhe pse jo me e bërë nga 500 të shkojë 300 mijë lekë. Ju jeni për arsye të çështjeve sociale për njerëzit në nevojë, nëse ka një drejtor që është këtu drejtor Shpati më fal Shpat me pagë të lartë nuk është normale .

Ledian Hasani . Atë person nuk mund ta heq dot unë, ka aplikuar.

Shpati Kolgega . Kjo është kredi e butë nuk është ndihmë ekonomike mos ta ngatërrojmë për ata që nuk kanë strehim mund të ketë njerëz normal me të ardhura të ulëta që nuk janë hallexhinj me kuptimin... dhe njerëz me të ardhura më të larta.

Silvana Aliu . Atë kredinë ti çoja atij personi që e ke marrë me qera nga Okshtuni dhe i ke marrë lekët e tërmetit, çoja atij.

Hekuran Xhani . Në rast se nuk shlyen shtëpinë ti, ajo i mbetet po bankës. A ka njeri këtu në këshill ka nevojë të marrë shtëpi, ne jemi të gjithë dakord kryetare të përfitojnë të gjithë qytetarët pa dallim bindjeje, ideje dhe kush ka kushtet ka nevojë për banesë sa më shumë qytetarë të përfitojnë kredi të butë është një shërbim që e paguan qytetari.

Silvana Aliu . Çdo ministri e arsimit e bujqësisë hap aplikimet për punonjësit e vet.

Indrit Dedej . Dakord nuk jam kundra por të ndihmojmë njerëzit në nevojë.

Hekuran Xhani . Se qenka një drejtor Silvanë po shtatë familjet tjera në nevojë mos i votojmë?

Silvana Aliu . Nuk po them mos e votojmë por herës tjetër të ketë parasysh njerëzit në nevojë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Fatmira Thartori . Unë jam dakord për këtë projektvendim.

Mukades Gixhari . Atëherë ndonjë diskutim tjetër? E hedhim në votim? Pikën 5 për tetë emrat e kredisë ? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.28. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.2783.Prot datë. 08.07.2025 " Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi 'Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025' " si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2783/1.Prot datë 08.07.2025.

Mukades Gixhari . Atëherë po në pikën 5 të rendit të ditës për mbledhjen e sotme ju pata njoftuar që do na vihej në dispozicion një projektvendim tjetër , "Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi "Subvencionimi interesave të kredisë për vitin 2025" lista me 4 familje përfituese, të cilën jua dërgova dje në grupin e ëhatsapp. Vazhdojmë po me drejtorin Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Janë 4 familje përfituese.

Hekuran Xhani . Tetë dhe katër 12.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. Listën me 4 familje. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.29. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3346.Prot datë. 18.08.2025 " Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi 'Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025' " si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3346/1.Prot datë 18.08.2025. (Lista me 4 familje).

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6, miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit 'Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese ' ". Jemi po me drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit Social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Këtu favorizohen qartë familjet që janë me të ardhura më të ulëta.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Hekuran Xhani . Kush janë famijet me të ardhura mesatare?

Ledian Hasani . I ka të parashikuar VKM nuk e kam me vete tani.

Hekuran Xhani . Meqë e mora fjalën sinqerisht të falenderoj për punën e bërë për problemin e atij Gazmend Leçinit nuk kam as lidhje gjaku as lidhje miku pra është bërë punë e shkëlqyer. Unë uroj që sa më shumë lum ai që i bën mirë tjetrit, të falenderoj dhe një herë tjetër.

Silvana Aliu . Po me procesin e shtëpiave të tërmetit ku jeni?

Ledian Hasani . Nuk ka lidhje me tërmetin.

Silvana Aliu . Ka lidhje me bashkinë.

Ledian Hasani . Tërmeti është fazë tjetër, ka bashki që nuk i ka prekur fare tërmeti por aplikimet vazhdojnë. Nuk mudn të presim të mbarojnë gjithë shtëpitë e tërmetit, pse duhet ta lejmë ne Gaz Leçinin psh?

Hekuran Xhani . Ne jemi dakord drejtor. A ka fonde shteti? Se shteti zgjidhet nga qytetarët për t'i shërbyer qytetarëve edhe ne si këshill nuk do dalim kundër nismës së ministrisë për t'i shërbyer qytetarit. Thashë unë për vete jo, ishalla thashë jo parita socialiste por edhe parti në moment që zgjidhet nga populli dhe është në shërbim të qytetarëve , t'i lejmë tani ne këto.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim pikën 6, miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit 'Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese ' ". Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr.30. Miratohet me 12 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3290.Prot datë. 12.08.2025 " Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit 'Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese' " si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3290/1.Prot datë 12.08.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 7, miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjen vendore Bashkia Rrogozhinë". Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Relaton drejtori i financës z. Rezart Vogli. Përshëndetje z. Rezart fjala për ju.

Rezart Vogli . Ju kemi paraqitur për miratim tavanet përfundimtare.

Silvana Aliu . Ti ke ardhur në fazën finale pa kaluar tjerat.

Mukades Gixhari . z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Nisur nga PBA 2025-2027 miratuam një fond për rivitalizimin e lagjes nr.1 Rrogozhinë dhe sot jemi në Gusht 2025 dhe informacioni për këtë fond 40 mijë lekësh. Dhe dje në komisionin e ekonomisë e diskutuam këtë. E kam kërkuar dhe zyrtarisht. Tani një zë tjetër po shoh blerja e automjeteve dhe pajisjeve për MZSH-në nuk e di me shifrat nuk gaboj por këtu thotë 10 mijë lekë me 4 zero. Kemi mbjellje për pyllëzim 200 mijë lekë, mund ta di cilat zona do pyllëzohen planifikimi që është bërë?

Hekuran Xhani . Ai i ka planifikuar lekët por sa pemë do mbillen...

Enver Memolla . Zona e kam fjalën. Një pikë për mbrojtjen e përroit me gabiona thotë.

Rezart Vogli . Është kaluar në këshill bashkiak.

Enver Memolla . Nuk është bërë akoma.

Rezart Vogli . Jo nuk është bërë.

Hekuran Xhani . Në ka një emergjencë mbi emergjencat bashkia Rrogozhinë është çështja e zjarreve. Duhet të merren masa që të mos përsëriten më katastrofat sepse janë djegur 407 shtëpi sipas statistikave. Një zjarrfikëse tre bote me ujë t'i ketë në dispozicion

Mukades Gixhari . Të nderuar këshiltarë e hedhim në votim pikën 7. Për miratimin e tavaneve përfundimtare. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim.Atëherë kemi 9 pro, dy kundra. Nuk miratohet.

-Nuk miratohet pika 7 e rendit të ditës me 9 vota pro 2 kundër.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 8, iratim i projekt-vendimit, "Mbi shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.14, datë 26.03.2024 'Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë ‘ ”.
-Atëherë, kemi një propozim nga dy kryetaret e grupeve politike për shfuqizimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.14, datë 26.03.2024 pra komisioni këshillimor për titujt e nderit i miratuar prej nesh me 2 përfaqësues të jashtëm , 1 këshilltar dhe 2 nëpunës të administratës së bashkisë. Ky shfuqizim sipas propozimit, hap rrugën që vlerësimet e titujve të nderit në vijim të bëhen nga komisioni këshillimor me përbërje vetëm anëtarë këshilli, miratuar me VKB-në Nr. 23 , datë 23. 06. 2025. Ndonjë diskutim?

Enver Memolla . Përpara se të miratonim komisionin e ri, pse nuk mor vendim në atë mbledhje për shfuqizimin e tjetrit, se kemi pasur dy komisione. Duhet të kishim bashkëlidhur procesverbalin nga komisioni i jashtëm, se komisioni ka qenë aktiv ka pasur 3 anëtarë.

Silvana Aliu . Si kaloi në këshill pa kaluar në komision, ne u ndeshëm me qytetarin.

Enver Memolla . Nuk duhet të përfshihen qokat .

Mukades Gixhari . Çfarë qokash e ke fjalën.

Enver Memolla . Qoka ishin radhën e kaluar se kur ngrihet një komision ... Komisioni i parë gjithmonë ka dalë me preteksin nuk jemi mbledhur nuk kemi kuorum.

Alime Hoxha . Me idenë që ai komision nuk funksiononte ne menduam që të bëni, komision me këshilltarë.

Enver Memolla . Dhe unë thashë në qoftë se duhet të bëjmë një komision të dytë duhet të bjerë poshtë komisioni i parë.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim pika 8 (tetë) e rendit të ditës.

Vendim nr.31. Miratohet me 12 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Këshilltarët, me shkresë Nr.3331.Prot datë 15.08.2025 “Mbi shfuqizimin e vendimit të këshillit bashkiak nr.14, datë 26.03.2024 ‘Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për bashkinë Rrogozhinë‘ ” si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3331/1.Prot datë 15.08.2025.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Tani, informacion mbi situatën e zjarreve dhe masat që do të merren në vijim për parandalimin e tyre në bashkinë tonë. Për këtë pikë kam njoftuar Shtabin e Emergjencave Civile të Bashkisë Rrogozhinë, duke filluar të gjithë me radhë. Këtu kemi z. Besnik Dushku shefi i MZSH-së. Përshëndetje z. Besnik.

Besnik Dushku . Zjarret në bashkinë tonë fillojnë me datë 2 Korrik në Luz dhe janë bërë dëme shumë të mëdha, dëme në njerëz nuk ka.

Mukades Gixhari . Z. Hekuran thotë që nuk ka pasur zjarr në Luz.

Besnik Dushku . Tek vreshti i ...

Elton Xhani . Mbrapa shtëpisë së Klodit tek varrezat.

Hekuran Xhani . Nuk është Luzi aty, Harizaj ose Lekaj nejse.

Besnik Dushku . Në datën 10 në një kohë prej tre orësh kanë qenë 4 zjarre. Ka qenë zjarri në fshatin Rrostej Njësia Administrative Sinaballaj në orën 15;37 min kemi shkuar dy grupe në Rrostej jemi marë pastaj zjarr në Zanbishë nia grupin tjetër me automjetin për në Zanbishë pa mbërritur mjeti në Zanbishë më njoftuan për zjarr tek mbikalimi i Gosës . I kam kërkuar ndihmë Peqinit ishte në zjarr vetë, i kam kërkuar ndihmë Kavajës nuk më ka ardhur. Jam shkëputur nga Rrosteji kam ardhur tek mbikalimi me një grup dhe automjetin zjarrfikës. Pa mbaruar shuarjen e zjarrit tek mbikalimi jam njoftuar që ka rënë zjarr po digjen shtëpiat në Gosë të madhe. Jemi shkëputur me mjetet zjarrfikëse , kemi bërë luftë si zjarrfikës edhe janë goditur çunat . Pyjet nuk janë mirëmbajtur rrugë nuk ka , nuk futet mjeti zjarrfikës. Unë si shef stacioni si shef shërbimi zjarrfikës parësore kam jetën e zjarrfikësit nuk i jap dot urdhër shoferit zjarrfikës futu thyej qafën. Kompetent për futjen e mjetit zjarrfikës është shoferi të futet në vendet maksimalisht të lejueshme pra të mbrojë jetën e vet dhe të efektivit që ka lart. Kemi qenë disa herë duke u djegur pranë banesave për të shpëtuar njerëz. Pastaj zjarri mori përmasa ku kaloi fshatrat Karresh, Memollaj , Hemenrajë. Kur ishim në përfundim të zjarrit në fshatin Kalemaj njoftohemi për zjarr pranë banesave të Shimve. Pa mbaruar zjarri në fshati Domen kishte zjarr në fhsatin Peqinaj Bashkia Kavajë ndërhyrja nga ajri nuk na u ofrua për arsye të errësirës. Pa mbaruar në fshatin Domen njoftohemi për zjarr në fshatin Okshtun në mëngjes arrijmë ta fikim. Më pas njoftohemi në Hemenrajë po digjen shtëpiat, pa mbaruar fikjen e zjarrit në Hemenrajë njoftohemi që u aktivizua sërsih zjarri në fshatin Stërbeg, u detyruam lam një grup në Hemenrajë nisemi me tre grupe të tjera drejt zjarrit. Kërkoj nga ju si këshilltarë që të njoftoni në raste të tilla përveç Verit

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

që më ka njoftuar do kërkoja të më merrni jam filan anëtar këshilli kam parë zjarrin rruga e kalimit është kjo, kjo shtëpia është në rrezik mos dëgjoni se çfarë thotë njëri apo tjetri se ai thotë po më digjet shtëpia ndërkohë që tjetri është në rrezik. Edimë se si janë rrugët e dimë se si janë pastrimet e rrugëve.

Mukades Gixhari . Unë ju kam marrë në telefon bashkë kemi kontaktuar .

Besnik Dushku . Po bashkë po.

Mukades Gixhari . Dmth unë ju kam kontaktuar nëpërmjet fjalëve të këshilltarëve.

Besnik Dushku . Kryetare nuk kam asgjë , por në bazë të prezantimit që unë jam anëtar këshilli unë do ta vlerësoj shumë.

Hekuran Xhani . Unë ju përgëzoj dhe ju falenderoj ju si staf zjarrfikës, shkaktarët e zjarrit janë temperatuat janë të larta, erërat gjithashtu, shpopullimi i cili ka prekur i cili ka prekur gjithë Shqipërinë. Dua të ndalem në kapacitetet që keni ju sepse ti trajtove shumë probleme por a i ke ti kapacitetet në njerëz dhe mjete për të ju përgjigjur kësaj situate në rast se nuk i ke, a ke bërë kërkesë ti bashkisë, ministrisë që gjithë kjo bashki ka një zjarrfikëse të vitit përnjeherë me mua tani , janë djegur deri tan 407 shtëpi për të blerë 800 zjarrfikëse. Dëmi që i është bërë ullinjve është kolosal që për mua dhe qeveria sdo ktë kurrë mundësi për kompensuar këtë dëm të shkaktuar qytetarëve.

Besnik Dushku . Kërkesat janë bërë.

Hekuran Xhani . Në raste të jashtëzakonshme duhen kaq mjete në raste të zakonshme duhet 1 mjet zjarrfikës apo dhe 2. Me kapacitete maksimale si ky vit a keni ju kapacitete, më mirë leni një rrugë pa bërë një vit 400 milion lekë dhe blini një zjarrfikëse sepse rruga bëhet vitin tjetër ato ullinj nuk bëhen më vitin tjetër.

Lulzim Hasa . Temperaturat e larta, era, tokat e pashfrytëzuara ,puna e zjarrfikësve ardha nga ajri dhe angazhimi i komuntetit ka qenë i madh në Stërbeg.

Silvana Aliu . Në radhë të parë u ankuat që në fshatin Stërbeg nuk po merr masa asnjëri.

Mukades Gixhari . Lulzim Hasa tha po digjemi dhe unë i jam përgjigjur kam folur me shefin.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Enver Memolla . Për sa i përket asaj që thotë Besniku kam qenë vetë prezent në dy zjarre dhe realisht nuk kanë çfarë bëjnë, kur u miratua një plan masash nga bashkia u tha që do pajisen me pompa uji me lopata e kazma, unë kam bërë një pyetje po koridore sa keni hapur, rrugë të reja sa keni hapur? Duhet një plan në bashkëpunim dhe me OSHE-në, sepse tre zjarre kanë rënë nga amortizimi telave apo shtyllave të rrjetit elektrik. Plani masave fillon nga A-ja, rrugët , tek lagjja e Shimve nuk hynte dot zjarrfikësja . Kur ra zjarri në Stërbeg ka qenë me mua Besniku në Hemenrajë nga atje të vish në Rrogozhinë do 40 min. Duhet bashkëpunim për këtë pjesë. Mbi stacionin e trenit janë pothuajse tre pompa uji nuk mund të bëhet një saraçineskë të vijë zjarrfikësja aty, tek lagjja Aliajve tek lagjja Kodër tek lagjja ime lart.

Silvana Aliu . Ajo që thotë Veri është e drejtë.

Besnik Dushku . Në Lekaj nuk ke, asnjë njësi administrative nuk ke. Dhe ajo zjarrfikëse është marrë me ndërhyrje nga fondet e Ministrisë së Brendshme nuk është marrë me fondet e bashkisë dhe ajo që kemi.

Indrit Dedej . Unë e kam këtu që ka rënë zjarri ka shkuar dhe i ka thënë filan vend ka rënë zjarri dhe nuk e kanë begenisur.

Besnik Dushku . Po të më vish ti apo një punonjës i bashkisë dhe të më thotë Besnik rruga për të kaluar është këtej, që ta kapim sa më shpejt zjarrin .

Adriatik Leka . Në periudhën Prill-Maj kemi miratuar një plan të emergjencave civile . Në Prill - Maj unë Besi bëmë takim në çdo njësi vendore me administratorët për ndërhyrjet vullnetare dhe me mundësitë që ka njësia mënyra se si do funksionojë. Edhe njëherë veprimet janë bërë .

Indrit Dedej . Kryeplaku i fshatit ka shkuar është ankuar dhe nuk është dëgjuar.

Besnik Dushku . Ti për cilin zjarr e ke se ta jap unë hajde kur të duash ta jap unë aktin e ekspertimit për çdo zjarr ka akt ekspertimi.
Bashkia nuk do vijë të pastrojë dhe shtëpiat nga bari.

Silvana Aliu . Ne po flasim për zjarrin që ka rënë në Bashkinë e Rrogozhinës as kryetari as nënkryetari nuk e çajnë kokën.

Besnik Dushku . Jam dakord me atë që thoni të jetë kryetari të jetë policia, elektriku mua dhe Tikun në 2 të natës na keni në dispozicion se kjo është puna jonë. Ama kështu si po e diskutojmë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

taman ne nuk zgjidhim gjë elektriku duhet të kontrollojë të gjithë linjën elektrike që kalon në territorin e bashkisë.

Indrit Dedej . Policia shtetit varet është pjesë e strukturës së bashkisë se më the që ne nuk...

Hekuran Xhani . Policia e shtetit?

Indrit Dedej . Rajoni Rrogozhinës.

Hekuran Xhani . Bashkëpunim.

Indrit Dedej . Ka një komision brenda në bashki që bën kontrollin .

Mukades Gixhari . Indrit për çfarë e kishe atëherë?

Indrit Dedej . Për emergjencat për zjarrin.

Mukades Gixhari . Jeni dakord ta vazhdojë projektvendimin drejtoresha juridike që ta përfshijmë?

Shpati Kolgega . Nga kërkesat që janë bërë nga MZSH-japër një zjarrfikëse , tha për një bot fuoristradë?

Enver Memolla . Kryetare në lidhje me pyetjen për zjarrfikësen , bashkia kur përdor fondin e emergjencave për të blerë një zjarrfikëse pse nuk bëni ndryshime në zërat e buxhetit duke parë që ke fond akoma ekstra të paprekur . Jemi në Gusht deri në Tetor bëhen ndryshime në buxhet.

Hekuran Xhani . Problemi i zjarrit fillon që me Njësinë Administrative duhen ngritur dy grupe vullnetare . Problemi i administratës unë kam punuar aty na ka rënë zjarr dhe në Okshtun dhe siç ishim si administratë kemi shkuar dy ditë atje.

-znj . Silvana Aliu dhe z. Indrit Dedej ngrihen dhe drejtohen drejt daljes nga salla e këshillit.

Mukades Gixhari . Indrit kemi kërkesën e z. Hekuran Dedeji.

Hekuran Xhani . Kemi kërkesën për librin.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Kemi kërkesën për ...

Indrit Dedej . Kaloje...

Mukades Gixhari . Po duhet të jesh të ngresh dorën.

Ervis Shera . Ashtu e kaluam edhe komisionin këshillimor dhe me të drejtë thotë Veri... se e bëmë rishtazi në mbledhje hajde ta kalojmë e kaluam dhe çfarë kaluam nuk morëm vesh...

Mukades Gixhari . Dhe mbledhjen tjetër pastaj të japim llogari.

Ervis Shera . Dhe me të drejtë se duhej shfuqizuar komisioni i parë .

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi kuorumin e nevojshëm mbledhja e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit.

Shënim : Për shkak të cilësisë së dobët të audios ky procesverbal nuk është zbardhur fjalë për fjalë.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 00°° . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 01 orë ; 31 min ; 55 sek.

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 15 (pesëmbëdhjetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner